



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE
UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS SH.A.
KËSHILLI MBIKQYRËS

Nr. 1053/Prot.
3

Durrës, më 26/02.2026

V E N D I M

Nr.2. Datë 26.02.2026

"PËR

MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË PLANIT OPERACIONAL-FINANCIAR 2026;

Këshilli Mbikqyres pasi mori në shqyrtim Propozimin nr 837/1 prot, dt .dt 18.02.2026 të paraqitur nga Administratori i shoqërisë dhe Bordi I drejtoreve te mbeshtetur ne Relacionin nr 837 prot, datë 10.02.2026 si dhe Shkresën nr 802 prot Tonën të Agjencisë Kombëtare Ujësjellës Kanalizime , datë 09.02.2026. Si dhe ;

Në mbështetje të nenit 167 të Ligjit Nr 9901, datë 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", baze te Ligjit nr.10296 date 08.07.2010 "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin", VKM-se nr 302 datë 11.05.2022 "Për Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit,trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura " Statutit të Shoqërisë;

V e n d o s i:

1. Miratimin e Rishikimit të Planit Operacional dhe Financiar të vitit 2026 (sipas propozimit nr _837/1 prot, dt 18. 02. 2026 të Administratorit).
2. Ngarkohet Administratori për zbatimin e këtij vendimi dhe për dërgimin e tij për miratim nga Asambleja.

KËSHILLI MBIKQYRËS

Znj. Anisa Jakllari

Znj. Juna Pali

Znj. Almiva Llaçi

Z. Aranit Gelaj

Z. Adrian Malaj

Kryetar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Anëtar



**UJËSJELLËS
KANALIZIME
RAJONI DURRËS**

Adresa: L.17.Rr. Daut Pëza e-mail: info@shkud@ukdurres.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE
UJËSJELLËS KANALIZIME Durrës S.H.A.

Nr. 834/1 prot.

Durrës, më 18/02.2026

Lënda: Propozim për rishikim të Planit Operacional dhe Financiar të vitit 2026

Drejtuar: Zj. Anisa Jakllari
Kryetare
KËSHILLI MBIKQYRËS
SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME Durrës

E nderuar Zonja Kryetare,

Në zbatim të VKM-së nr 302 datë 11.05.2022 "Për Politikën Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura, Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, Ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin financiar dhe Kontrollin, dhe Udhëzimit vijues të tij nr 30 datë 27.12.2011, Statutit të Shoqërisë Rajonale U.K.D sha, Rregullores së organizimit dhe funksionimit, projektit të AKUK "Përmirësimi i efikasitetit të energjisë dhe implementimi i paneleve fotovoltaike për shoqërinë Durrës, kontratës Studim Projektim nr.5616 prot., datë 18.11.2024, relacionit të Drejtorisë së Prodhimit nr.837 prot., datë 10.02.2026, Shkresë e AKUK me nr 802 prot, dt 09.02.2026 ju bëjmë me dije se;

Rrjeti shpërndarës i ujësjellësit dhe kanalizimeve paraqet sfida të shumta, si pasojë e amortizimit të infrastrukturës ekzistuese dhe lëvizjeve demografike në zonat urbane dhe turistike. Për këtë arsye, planifikimi i investimeve është bërë një prioritet i Shoqërisë Rajonale për të garantuar furnizim të qëndrueshëm me ujë dhe trajtim efikas të ujërave të zeza. Si pjesë e shërbimit të studim projektim janë tashmë gati 35-projekte në zona të ndryshme të shoqërisë rajonale, për të cilat nevojitet të shihet për mundësi financimi sipas prioriteve të shoqërisë.

Nga ana tjetër nevojiten të kryen disa rikonstruksione në asetët ekzistuese stacione pompimi/godina zyra, pasi kostoja e mirëmbajtjes apo shkalla e amortizimit ka sjellë problematika të vazhdueshme.

Sipas tematikës dhe objektivit të investimit paraqesim arsyetimet teknike për domosodshmërinë e miratimit të projekteve si më poshtë vijon:

INVESTIM PËRMIRËSIM EFIÇENSA E ENERGJISË

Bazuar Termat e referencës (Detyra e projektimit) si dhe në "Strategjia kombëtare e sektorit për furnizimin me ujë të pijshëm, largimin, grumbullimin e trajtimin të ujërave të ndotur urban, 2023 – 2030" Kryesisht sipas strategjise, në piken 3.4 Qëllimet e Politikës dhe Rezultatet / Masat Prioritare, Tabela 2, Politika 4, "Implementimi i një qasje të re në investimet në sektor drejt reduktimit të konsumit të energjisë, nëpërmjet investimeve për furnizimin me energji nga fotovoltaiket, vendosjes së pompave sipas kritereve të BE dhe instalimi i programit SCADA që rrit efektshmërinë e tyre".

Si pjesë e "Programit Kombëtar të Modernizimit të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve" në Shqipëri, ekipi i Bankës Botërore, AKUK dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë kanë përpiluar tre projekt zbatime për efikasitetin e energjisë dhe energjinë e rinovueshme për SHRUKD-në.

Programi global synon një reduktim prej 25% të konsumit të energjisë gjatë një periudhe 20-vjeçare, me kursime të pritshme prej 400 GËh.

Në fazën e projekt Idesë janë marrë parasysh komentet e bëra nga këshilli teknik të datës 7 Mars 2025 dhe është vazhduar me hartimin e projekteve për Rajonin e Durrësit i cili konsiston në 3 nënprojekte:

- D(1.1) Ndërtimi i një depo me volum 800 m³ në Kuratë dhe zvendësimi i 1.2 km tub
- D(1.2) Zëvendësimi i pompave në stacionin e Fushë Krujës
- D(1.3) Marrja e Masave për shuarjen e grushtit hidraulik (Ndërtimi i Depozitave për shuarjen e presionit)

Në këshillin teknik të mbajtur në AKUK në 7 Mars 2025 për projektet e parafizibilitetit, për rajonin e Durrësit u komentua që të hiqen nga analiza pompat me të reja se 15 vite dhe të konsiderohen pompat me të vjetra se 15 vite që janë jashtë performancës/ jashtë pune, të demtuara dhe në nevojë urgjente për zëvendësim.

Në bashkëpunim me Shoqërinë Rajonale të Ujësjetës Kanalizime Durrës janë mbledhur të dhëna rreth sistemeve të furnizimit me ujë me ngritje mekanike (qëllimi i projektit) dhe me vetërrjedhje. Mbas mbledhjes së të dhënave (bazuar në një tabelë me kërkesa të dorëzuar SHRUKD) është bërë analizimi i tyre për të evidentuar se kush nga sistemet prodhon më shumë ujë dhe harxhon më shumë energji në mënyrë që në fazat e mëtejshme ata të studiohen më në detaje.

Pasi është bërë mbledhja e informacioneve nga SHRUKD e cila u shërben bashkive: Durrës, Shijak, Kavaje, Rogozhinë, dhe Krujë, janë bërë dhe vizita në teren për të evidentuar dhe plotësuar informacionin e gjendjes ekzistuese janë përzgjedhur tre sistemet kryesore: Sistemi i Fushë Kuqes, Fushë Krujës dhe Cermë e Sipërme të cilët zënë në total rreth 80% të konsumit të energjisë që harxhon Rajoni i Durrësit për sistemet e furnizimit me ujë.

Zgjidhja konsiston në përmirësimin e pajisjeve elektromekanike dhe prodhimin e energjisë nga burime të rinovueshme (panele diellore). Për detyrën 2 janë dorëzuar dy raporte në të cilat

përmbalhet informacion i detajuar për te dhënat e matura dhe Auditit i eficiencës së energjisë në sistemet e furnizimit Fushë Kuqes, Fushë Krujës dhe Cermë e Sipërme, për informacion me të zgjeruar duhet të referoheni raportit:

- D3 – Aneksi me Matjet - SHRUK Durrës
- D4 - Raporti i Parafizibilitetit- SHRUK Durrës

Mbas përfundimit të Detyrës 2, faze në të cilën zgjidhen dhe llojet e ndërhyrjeve që do të kryhen në sistemet për të reduktuar harxhimin e energjisë në një përqindje rreth 16-20%. Në këtë fazë janë paraqitur skicë idetë dhe parametrat e pompave ose dhe ndërhyrjeve të tjera.

Për detyrën 3 është dorëzuar dosja me datë : Raportin e Projekt Idesë, Vizatimeve Teknike Draft, Grafikon e Punimeve, Specifikimet Teknike Draft, Volumet dhe Kosto e Punimeve paraprake. Projekt Ideja është paraqitur në keshillin teknik në AKUK në datën 20 Nentor 2025 dhe mbi baze të vendimeve të këtij keshilli teknik është vazhduar me Projekt Zbatimin.

Mbas përfundimit të Detyrës 3, janë reflektuar komentet dhe vërejtjet e bëra nga keshilli teknik dhe më pas janë përgatitur dokumentacionet përfundimtare të cilat duhen për aplikimin për oponente dhe më pas për tenderimin e projekt zbatimit

Objekti 1: Rindertimi i shuarsit të presioni në Kurate me kapacitet 800 m³, duke përfshirë tubacionin e gizes DN 700 për lidhjen me linjen ekzistuese, rrugën e shërbimit dhe sistemin e monitorimit me kamera

Vlerë 348,965,081 leke me tvsh

Përsa i përket prodhimit të energjisë së rinovueshme në Durrës nuk ka sipërfaqe të mjaftueshme në zonat e puseve ose stacioneve të pompave dhe për këtë arsye është e vështirë realizimi i një projekti për panelet fotovoltaike.

Është realizuar një fushatë për matjen e parametrave të pompave (prurje, presion, fuqi) dhe për matjen e sistemit të dërgimit (matja për 3 dite e prurjes në dalje të stacionit dhe matje e prurjes në hyrje të depove). Mbas analizimit të të dhënave të matura janë përcaktuar rendimentet e pompave, problematikat ose humbjet teknike në rrjetin kryesor (nga stp tek depot), dhe më pas janë dhënë zgjedhje në mënyrë që të kemi një rritje të eficiencës së energjisë.

Grupet e gjeneratorëve rezervë në pikat e stacioneve të pompimit janë të rëndësishme për ruajtjen e vazhdimësisë së operacioneve, veçanërisht gjatë ndërprerjeve të energjisë ose dështimeve të rrjetit. Gjeneratorët e rezervë sigurojnë energjinë e nevojshme për të mbajtur pompat në funksion, duke parandaluar ndërprerjet që mund të çojnë në mungesë uji ose ndërprerje të shërbimit.



**UJËSJELLËS
KANALIZIME
RAJONI DURRËS**

Adresa: L.17.Rr.Dalip Peza e-mail: info@ukdurrës.al

Aktualisht, stacionet e pompimit në SHRUK Durrës nuk janë të pajisura me gjeneratorë rezervë. Konsulenti thekson rëndësinë e kapjes së të gjitha informacionit të nevojshëm në lidhje me furnizimin me energji për pajisjet rezervë.

Megjithatë, në kontekstin e Shqipërisë, ku rrjeti i shpërndarjes OSHEE njihet për besueshmërinë e tij, urgjenca për masa të tilla të gjerë është dukshëm më e ulët. Performanca e qëndrueshme e rrjetit e ul ndjeshëm mundësinë e ndërprerjeve, duke treguar se, megjithëse sistemet e energjisë rezervë janë thelbësore për mjedise me konsum më të madh, ato mund të mos jenë aq kritike këtu, ku stabiliteti i rrjetit ofron një mbrojtje të fortë kundër humbjes së energjisë.

Analiza teknike tregon se mund të instalohen banka kapacitorësh në panele të kontrollit të tensionit të ulët (LV) të pompave, dhe instalimi është teknikisht i thjeshtë, pasi ka pasur raste të ngjashme në disa stacione pompimi. Kostoja e pritur është e ulët dhe pritet një kthim i investimit shumë i shpejtë bazuar në kursimet e energjisë që lidhen me reduktimin e energjisë që merret nga rrjeti, duke u vlerësuar një kthim mesatar prej 30 ditësh.

Linja e transmetimit të Fushë Kuqes operon me presione shumë të larta në segmentet malore, veçanërisht midis Ishmit dhe Kuratenit. Daljet e fshatrave më poshtë vuajnë nga presione të tepërta dhe defekte të shpeshta, ndërsa segmentet më sipër kanë kushte të paqëndrueshme për shkak të pompimit të vazhdueshëm pa një element rregullues hidraulik në mes.

Studimi i Fizibilitetit analizoi ndërtimin e një Depoje të Shuarjes së Presionit (DSP) për të stabilizuar presionet, përmirësuar furnizimin e fshatrave dhe mbrojtur linjën ngagoditjet hidraulike. Ndërtimi i depos në Kuraten rezultoi i vetmi vend teknikisht i realizueshëm.

Niveli i ujit në DSP = 224 m

- o Funksional për të gjithë skenarët.
- o Jep -1.6 bar në Ishëm.
- o Mundëson 693 L/s drejt Arapaj.
- o Presion (lartësi) pompimi brenda projektit (H=325-328 m).
- o Më ekonomik.

Vellimi i Depos

800 m³ → ~16.7 minuta rezervë në 800 l/s

Me poshte Jepet Plan Vendosja e Depos Se Kurates dhe Nje Prerje Terthor

Në diskutim me PCU, AKUK dhe AFD është dakordësuar që skema përfundimtare e Sistemit të Fushë Kuqes të përfshijë Shuarësin e Presionit në Kuratë (kuotë 224 m m.n.d) me volum 800 m³. Gjitashtu do të realizohen punimet për rrugën e aksesit, furnizimin me energji elektrike si dhe realizimin e linjës së tubacionit shtesë të Gizës për një gjatësi rreth 1.3 km për lidhjen e shumërisit të ri me linjën ekzistuese.



Rivendosja e Shuarësit të Presionit në Kuratë për Skemën e Fushë Kuqes do të sjellë një optimizim të punës së pompave si dhe një vlerë të konsiderueshme të energjisës.

Llogaritjet finale për të gjithë skemën e Fushë Kuqes duke përfshirë Stacionin e pompave dhe ndryshimet përgjatë linjës deri në depot e qytetit të Durrësit

Objekti 2: Përmirësimi i efencës së energjisë dhe implementimi i Paneleve Fotovoltaike për Shoqërinë Durrës- Fushë Krujë

Vlerë 52,134,330 leke me tvsh

Stacioni i pompimit të Fushë Krujës përbëhet nga 5 pompa ku 3 janë në gjendje pune, njëra mungon dhe një tjetër është jashtë përdorimi. Pompat janë centrifugale horizontale dhe çojnë ujë të depo e Shilores. Në stacion ndodhet një depo 500m³ që grumbullon ujin nga pusët dhe që shërben për furnizimin e pompave shtytese

Konstatimet kryesore dhe problemet e identifikuar pas fushatës së matjeve:

- Për shkak të kufizimeve të punës, niveli i humbjeve të ujit nuk mund të vlerësohet. Veçanërisht në këtë linjë ka një lidhje kryesore për në Vorë të pa matur.
- Në pompa janë të matura rendimente të ulëta. Pompat punojnë jashtë intervalit të tyre të projektuar. Për ta përshtatur me instalimet ekzistuese dhe për të plotësuar kërkesën për ujë, operatori është i detyruar të përdorë valvulën e shkarkimit për të ulur presionin në dalje të pompave dhe për të menaxhuar mbingarkesën e motorit.
- Pompat e 6 puseve tregojnë një performancë të ulët energjitike.
- Në këtë moment kërkesa e ardhshme për ujë në Fushë-Krujë është e panjohur. Projektimi i tubit mund të pranojë deri në 6 pompa që punojnë në të njëjtën kohë.

Zëvendësimi i 3 pompave centrifugale me aks horizontal që janë aktualisht jashtë shërbimit nga 5 pompat, duhet të kryhet me një projekt të ri dhe të përshtatshëm për të përmirësuar performancën energjetike. 2 Pompat e tjera (te cilat janë në gjendje pune) duhet të mbahen në rast dështimi të 3 pompave të reja. Janë identifikuar zona të cilat kanë nevojë riparime dhe punime civile të nevojshme për të siguruar kushte të mira për punimin dhe mirëmbajtjen e pompave.

Karakteristikat e rekomanduara të pompave të reja centrifugale me aks horizontal dhe skema e punës janë si më poshtë:

■ $Q = 90 \text{ l/s}$



**UJËSJELLËS
KANALIZIME**
RAJONI DURRËS

Adresa: L.17.Rr.Dalip Peza e-mail: info@ulldurres.al

- H = 140 mku (ky presion rezultoi i njaftueshem nga matjet dhe analiza e bere per kurbat e pompave)
- Funksionimi i rekomanduar: 2+1 me valvulë shkarkimi në hapje 100%
- Orët ditore të punës individuale: 14

Ne keshillin teknik te mbajtur ne AKUK ne 20 Nëntor 2025 per projekt Idene, per rajonin e Durrësit u vendos që të përdoren pompa centrifugale me aka horizontal tek Stip Fushë Krujë (me rendimentin maksimal) si dhe te gjitha rakorderite dhe tubacionet qe do te nderohen te jene prej Inoksi.

Objekti 3: Përmirësimi i efencës së energjisë dhe implementimi i Paneleve Fotovoltaike për Shoqërinë Durrës- Shuarsi Kuratë - Çermë

Vlerë: 9,900,589 leke me tvsh

Stacioni i pompimit të Çermës së Sipërme përbëhet nga 3 stacione që mbulojnë zona të ndryshme. Ata përbëhen nga 3 pompa që furnizojnë Kavajën, 2 pompa që furnizojnë Lushnjën/Divjakën dhe 2 pompa që furnizojnë Rrogozhinën.

1.Puset Çermë e Sipërme

Stacioni i Çermës ka 7 puse ku njëri nga këta ndodhet brenda stacionit të pompimit ai nr.7 dhe të tjerët janë të shpërndarë në distancë dhe të gjithë shkarkojnë në një dhomë ajrimi ku edhe klorifikohet uji, pastaj me gravitet mbushen dy depot që ndodhen në stacion. Puset janë me pompa zhytëse me karakteristika si mëposhtë:

Ne Brendesi te Stacionit jane dhe dy depot qe grumbullojne ujin qe vjen nga puset. Depo E vjeter 500 m3 dhe Depo e Re 1000 m3.

2.Stacioni i Pompave qe Furnizojne Kavajen

Përbëhet nga 3 pompa centrifugale horizontale me karakteristika (Q=125 l/s, H=146 m dhe P=315 kE). Punohet me 2 pompa njëkohësisht dhe 1 pompë rezervë. Pompat dërgojnë ujë në shuarësin e presionit në kodrën e Beut I cili pastaj me gravitet furnizon depot Kavajë (e Re 5500 m3 dhe e Vjetër 2000m3) si dhe depot në Golem (2x4000m3). Pompat marrin ujë nga depo e re që ndodhet në stacionin e pompimit. Ata dërgojnë ujë me tub çeliku DN500 dhe ka një matës, por që është jashtë funksioni.

Pompat ne Stacionin e Cermes se Sipërme, pompojne uje ne Shuaresin qe ndodhet ne Kodren e Beut. Me pas nga Shuaresi Uji shkon Nepermjet Dy tubacioneve DN 500 njeri drejt Depove te Kavajes dhe Tjetri Drejt Depove ne Golem.

- Shuaresi tek Kodra e Beut dhe Depot ne Kavaje



**UJËSJELLËS
KANALIZIME
RAJONI DURRËS**

Adresa: L.17, Rr. Dalip Posa e-mail: info@ukdurrës.at

Depot ne kavaje jane 2, e vjetra me kapacitet 2000 m³ dhe e reja me kapacitet 5500 m³. Depo e re dhe ajo e vjeter jane ne Disnivel (e reja eshte me lart) dhe duhet qe operatori te hapi/mbylli njeren valvul qe te mbushet secila depo vec e vec.

3.Pompat që çojnë ujë në Lushnje/Divjakë

Stacioni i pompimit përbëhet nga 2 pompa centrifugale horizontale me karakteristika (Q=61.1 l/s dhe P=132 kE). Pompat dërgojnë ujë me tub DN300 drejt qytetit të Lushnjes. Ata punojnë me 1 pompë dhe tjetra rezervë. Këto pompa marrin ujë nga depo e vjetër që ndodhet në stacion. Nuk kanë matës prurjeje dhe matja bëhet me orë pune të pompës.

4.Pompat që çojnë ujë në Rrogozhinë dhe depo

Stacioni i pompimit pompimit të Rrogozhinës përbëhet nga 2 pompa centrifugale horizontale të vogla. Ato marrin ujë nga depo e vjetër dhe çojnë ujë drejt depos Rrogozhinë me volum 2000m³ ujë. Ato kanë karakteristika (Q=43.7 l/s, H=89.6 m dhe P=55 kE). Pompat punojnë me turne. Ka matës të prurjes elektronik akumulativ.

Pompat e Rrogozhines pompojne ujin direkt per ne Depon qe ndohet mbi Qytetin e Rrogozhines. Depo eshte e re dhe ka nje volu uji 200 m³.

Problematikat ne stacionin e cermes se sipërme

Nga informacioni i mbledhur në vend dhe shqetësimet e shprehura për operatorin ka pak vërejtje për këtë stacion:

- Linja elektrike jep defekte dhe ndërprerje gjate stuhive, për këtë arsye propozohet ndërtimi i një linje te re unaze elektrike.
- Ujëmatësit nuk funksionojnë
- Linja e tubacionit te Rrogozhines dhe asaj te Kavajes kane probleme me Grushtin Hidraulik. Jane demtuar valvulat e moskthimit.
- Sistemi i kontrollit është manual (nuk ka SCADA)
- Në zonën e stacionit të pompimit dhe gjithashtu në puse nuk ka shumë hapësirë për të parë mundësinë e impiantit PV (kjo tokë duhet kërkuar në disa zona të tjera).

Vlerësim i efikasitetit të pompës

Një bazë të dhënash gjithëpërfshirëse është hartuar nga matjet e kryera gjatë hetimit të secilës pompë. Këto informacione të vlefshme shërbejnë si baza për studimin e efikasitetit të energjisë të Konsulentit. Për secilin stacion pompimi, gjendja e pompave përkatëse është detajuar në fletë të dhënash të matjeve të dedikuara që u përmendën më parë. Gjetjet e kësaj analize të efikasitetit të energjisë paraqiten në seksionet e mëposhtme, duke ofruar pasqyra mbi performancën dhe mundësitë e optimizimit për secilën pompë të hetuar.

Qasja përfshin krahasimin e daljes së matur të pompës me vlerat e pritshme të standardeve për kategorinë specifike të pompimit. Diferenca midis këtyre dy shifrave tregon mundësinë për



reduktimin e fuqisë. Kjo mundësi më pas kthehet në kursime energjike duke përfshirë orët më të mëdha ditore të operimit të pompës.

Të dhënat tregojnë se shumica e pompave të vlerësuara po performojnë nën nivelet e rendimentit optimal dhe të garantuar. Megjithatë, sugjerojmë të mbahen pompat që janë brenda 15 viteve të instalimit, në vend që të zëvendësohen menjëherë, duke u fokusuar në rastet më kritike. Dhe pompat e puseve të rehabilitohen, dhe ose nderohen vetëm në rastet që kanë dalë jashtë funksionit.

Instalimi i matësve të rekomanduar

Investimi dhe implementimi i një sistemi të plotë matës për monitorimin e prodhimit të ujit dhe performancës së pompave është thelbësor për optimizimin e efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së operacioneve të furnizimit me ujë. Duke integruar mjete të avancuara si matësit e prurjes, matësit e presionit në dalje dhe matësit e energjisë, shërbimet komunale mund të fitojnë njohuri të sakta mbi dinamikat operationale në infrastrukturën e ujit.

- Matësit e prurjes ofrojnë matje të sakta të volumit të ujit, duke siguruar që nivelet e prodhimit të përputhen me kërkesën pa humbje.
- Matësit e presionit në dalje ndihmojnë në ruajtjen e niveleve optimale të presionit, duke parandaluar dëmtimin e mundshëm të sistemit dhe duke siguruar furnizim të qëndrueshëm me ujë.
- Matësit e energjisë gjurmojnë konsumimin e energjisë së pompave, duke mundësuar identifikimin e efikasiteteve të ulëta dhe mundësive për kursime të energjisë.

Se bashku, këta instrumente jo vetëm që përmirësojnë besueshmërinë dhe performancën e sistemeve të furnizimit me ujë, por gjithashtu kontribuojnë në reduktimin e kostove dhe përfitime mjedisore duke promovuar ruajtjen e burimeve dhe uljen e përdorimit të energjisë. Ky investim strategjik është thelbësor për shërbimet e ujit moderne që synojnë të arrijnë ekselencën operative dhe qëndrueshmërinë.

Objekti 4: Furnizim dhe vendosje elektropompa në stacionin e pompave Fushë-Milot

Vlerë: 150,000,000 lekë pa tvsh

Me zhvillimin e zonave turistike përgjatë vijës bregdetare të Bashkisë së Durrësit shihet e domosdoshme që të sigurohet shërbimi i furnizimit me ujë i kontratave ekzistuese dhe fluksit të kërkesave të reja, gjë e cila fokuson vëmendjen në menaxhimin e sasisë së ujit të prodhuar në burimet e furnizimit me ujë.

Njësia Operative Durrës e mundëson shërbimin e furnizimit me ujë nga tre burime me ngjitje mekanike, përkatësisht: Burim Fushë Kuqe, Fushë Milot dhe Fushë Krujë. Secili prej tyre ka stacionin qëndror të pompimit, me anë të cilëve bëhet i mundur transportimi i ujit nga vendi burimit për në zonën e shërbimit të kësaj njësie. Me zhvillimin e zonave turistike bregdetare dhe



**UJËSJELLËS
KANALIZIME
RAJONI DURRËS**

Adresa: L.17, Rr. Dalip Peza e-mail: info@ukdurrës.at

shtimit të kërkesës për ujë shihet e domosdoshme të sigurohet efienca e plotë e prodhimit në këto burime.

Burimi Fushë-Milot ndërtuar gjatë vitit 2019 nga Projekti Bankës Botërore, prodhon ujë nga 7 puse me thellësi 55-64 m. Aktualisht janë në operim 5 puse me kapacitet 115-150 l/sek. Në stacionin e pompimit janë 8 pompa zhytëse, me fuqi 350 Kw. Që në momentin e marrjes në dorëzim të këtij investimi është konstatuar që montimi në pozicion horizontal i pompave zhytëse në stacion ka nxjerrë problematika gjatë vënies në punë të stacionit, të detajuara në Relacionin e Drejtorit teknik dhe Drejtorit të prodhimit me nr 837 prot date 10.02.2026.

Aktualisht, sipas verifikimit teknik dhe evidencave operative:

- 4 pompa janë jashtë funksioni
- 4 pompa janë në funksion

Ndërkohë që me qëllim që stacioni të prodhojë kapacitetin e duhur dhe të mbulojë nevojat e konsumit, teknikisht duhet që 6 pompa duhet të jenë në funksion të vazhdueshëm, 1 pompë për ndërrime/manovrim dhe 1 pompë reserve.

Stacioni paraqet probleme të përsëritura teknike në pompat e instaluara, të cilat funksionojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe nën ngarkesë të lartë. Defektet kryesore lidhen me:

- Konsum të përshpejtuar të komponentëve mekanikë
- Probleme të përsëritura në elektromotorë
- Funksionim jo optimal dhe rendiment të ulët të pompave

Referuar të dhënave të performances, evidentohet:

- Rendiment i ulët i pompave,
- Kufizime operative në disa njësi
- Konsum i lartë specifik energjie, tregues i funksionimit jo eficient

Me kalimin e viteve janë evidentuar vazhdimisht difekte në pompat e stacionit për të cilat janë kryer mirëmbajtje/avolxhime shoqëruar me kostot përkatëse.

Gjatë viteve 2024-2025 janë kryer: 3 avolxhime elektromotorësh, 5 riparime pompash dhe vendosje e një pompe të re, duke përfshirë dhe kostot e mirëmbajtjes të vitit 2023 në total vlera për këto shërbime rezulton rreth **52 mln lekë**. Këto ndërhyrje janë realizuar për të ruajtur kapacitetin prodhues të stacionit dhe për të shmangur ndërprerjet e furnizimit.

Situata aktuale paraqitet problematike pasi, stacioni punon pa rezerva teknike duke qënë i ekspozuar vazhdimisht ndaj ndërprerjeve të menjëhershme, me mbingarkesë të pompave që janë në punë, nuk arrin të garantohet prodhimi i sasisë së ujit me qëllimi përballimin e rritjes së kërkesës për ujë gjatë sezonit turistik në qytetin bregdetar të Durrësit.

Në përfundim, investimi për furnizimin dhe vendosjen e elektropompave të reja në stacionin e pompave Fushë-Milot përbën një ndërhyrje thelbësore dhe me karakter strategjik për garantimin e sigurisë së furnizimit me ujë në zonën e Durrës. Situata aktuale e operimit, me mungesë rezerve teknike dhe me mbingarkesë të vazhdueshme të pompave funksionale, paraqet risk të lartë për ndërprerje të furnizimit, veçanërisht gjatë sezonit turistik kur kërkesa për ujë arrin nivelet maksimale.



**UJËSJELLËS
KANALIZIME**
RAJONI DURRËS

Adresa: L. 17, Rr. Dalip Peza e-mail: info@ukdurrës.al

Zëvendësimi i pajisjeve ekzistuese me elektropompa të reja dhe me rendiment më të lartë do të përmirësojë ndjeshëm eficiencën energjetike, do të reduktojë kostot e mirëmbajtjes së përsëritur dhe do të rrisë qëndrueshmërinë operacionale të stacionit. Për më tepër, krijimi i kapacitetit të plotë funksional dhe i rezervës teknike do të minimizojë riskun operacional dhe do të sigurojë stabilitet në prodhimin e ujit për Njësinë Durrës.

Ky investim nuk përfaqëson vetëm një përmirësim teknik të një asemi ekzistues, por një garanci për vazhdimësinë e shërbimit, mbështetjen e zhvillimit ekonomik dhe turistik të zonës, si dhe për forcimin e qëndrueshmërisë afatgjatë të sistemit të furnizimit me ujë.

II. INVESTIME REDUKTIV HUMBJE TEKNIKE DHE ZONA TURISTIKE

Referuar kontratës me konsulencën projektuese Invictus me nr.5616 prot., datë 18.11.2024 me objekt: "Studim projektim për rikonstruksionin e rrjetit të ujësjellësit në: Nj.Adm.Synej, Nj.Adm.Golem, Nj.Adm.Fushë-Kuqe, Nj.Adm.Thumane, Nj.Adm.Maminas, Nj.Adm.Manëz, Nj.Adm.Rrashbull", janë dorëzuar pranë shoqërisë 35 projekt-studime për zonat pjesë të detyrës së projektimit përmbledhura në tabelën e mëposhtme sipas bashkive:

| Nr. | Emërtimi | Vlera |
|-----|---|----------------------|
| 1 | Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të fshatrave të Njësisë Administrative Synej dhe Golem, Bashkia Kavajë | 1,490,122,886 |
| 2 | Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të fshatit Bukaq, Nj.Adm.Synej, Bashkia Kavajë | 75,422,003 |
| 3 | Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të fshatrave të Njësisë Administrative Fushë-Kuqe dhe Thumane, Bashkia Kurbin dhe Krujë | 1,498,549,911 |
| 4 | Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të fshatrave të Njësisë Administrative Manëz, Bashkia Durrës | 793,469,279 |
| 5 | Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të fshatit të Njësisë Administrative Rashbull, Bashkia Durrës | 385,996,733 |
| 6 | Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të fshatrave të Njësisë Administrative Maminas, Bashkia Shijak | 523,794,496 |
| | SHUMA TOTALE | 4,767,355,309 |


Objekti 1: Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të fshatrave të Njësisë Administrative Synej dhe Golem, Bashkia Kavajë

Vlerë 1,490,122,885.27 leke me tvsh



**UJËSJELLËS
KANALIZIME
RAIONI DURRËS**

Adresa: L.17.Rr.Dalip Peza e-mail: info@ukdurrës.al



Zona e fshatrave të Njësisë Administrative Synej dhe Golem është një ndër zonat me zhvillim më të shpejtë turistik dhe ndërtimor në Bashkinë Kavajë. Gjatë viteve të fundit, kjo zonë ka përjetuar një rritje të ndjeshme të popullsisë, si rezultat i shtimit të ndërtimeve të reja banesore dhe turistike, si dhe i prurjeve sezonale të turistëve që shumëfishojnë kërkesën për ujë gjatë muajve verorë.

Rrjeti ekzistues i ujësjellësit në këto zona është i amortizuar, me materiale të vjetra dhe humbje të konsiderueshme në linjat e transmetimit dhe shpërndarjes. Këto problematika janë përkeqësuar nga rritja e pandërprerë e konsumit, presioni i ulët në linja, si dhe mungesa e zonimit hidraulik, që e vështirëson menaxhimin teknik dhe matjen e saktë të konsumit.

Për rrjedhojë, garantimi i sasisë dhe cilësisë së ujit të pijshëm është bërë gjithnjë e më i vështirë, duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e jetesës së banorëve dhe në shërbimin ndaj bizneseve turistike.

Në kushtet e zhvillimit të planifikuar urban dhe turistik, rikonstruksioni i rrjetit të ujësjellësit në fshatrat e Njësisë Administrative Synej dhe Golem është domosdoshmëri për të siguruar një furnizim të qëndrueshëm, efikas dhe të përbërshëm me ujë të pijshëm, duke reduktuar humbjet në rrjet dhe duke garantuar mbulim të plotë me infrastrukturë në përputhje me standardet bashkëkohore.

Ky projekt ka për qëllim sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm me ujë të pijshëm për zonat urbane dhe turistike të njësisë, si dhe përmirësimin e parametrave hidraulikë të rrjetit ekzistues.

Në kuadër të këtij projekti, parashikohet realizimi i këtyre ndërhyrjeve kryesore:

- 1.Ndërtimi i linjës së furnizimit te depos se re nga burimi Çernë, për sigurimin e prurjeve të nevojshme të ujit nga burimi kryesor;
- 2.Ndërtimi i linjës së furnizimit nga burimi Maskuri, si pjesë integrale e sistemit të shpërndarjes për zonat periferike;
- 3.Ndërtimi i depos së re të ujit në Agonas, me kapacitet 6000 m³, e cila do të shërbejë si rezervuar balancues për furnizimin e qëndrueshëm të gjithë njësisë;
- 4.Ndërtimi i linjës kryesore të shpërndarjes, që do të mundësojë lidhjen hidraulike të pikave kryesore të furnizimit;
- 5.Ndërtimi i unazës kryesore të rrjetit, me qëllim rritjen e sigurisë së furnizimit dhe uljen e humbjeve në rrjet;
- 6.Ndërtimi i linjave shpërndarëse, për mbulim të plotë të zonave të banuara dhe të zhvillimit turistik (22 zona) përfshirë edhe linjën e shpërndarjes në zonat Kolje, Agonas dhe Rakull (fshati i cili nuk ka rrjet furnizimi).
- 7.Sistemi SCADA

Ky investim parashikohet të rrisë ndjeshëm sigurinë hidraulike të sistemit, të përmirësojë cilësinë e shërbimit ndaj konsumatorëve dhe të sigurojë furnizim të pandërprerë me ujë të pijshëm në një zonë me rëndësi të veçantë për zhvillimin turistik të Bashkisë Kavajë.

Projekti në total përfshin rikonstruksionin e rrjetit të ujësjellësit për fshatrat Qerret, Agonas, Krakëll dhe Kolje. Sipas problematikave ndeshur gjatë sezonit veror në këto njësi mbetet prioritet për tu zgjidhur sa më parë investimi në zonën bregdetare Qerret projektuar në 22 zona.

Impakti në kontrata të reja: në fshatin Rakull nuk kemi kontrata dhe referuar të dhënave për numrin e popullsisë pritet të hapen **365 kontrata të reja**.

Objekti 2: "Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të fshatit Bukaq, Njesia Administrative Synej - Bashkia Kavaje"

Vlerë 75,422,003.07 leke me tvsh

I. Gjendja ekzistuese

Fshati **Bukaq**, në Njësinë Administrative Synej, është një zonë kryesisht rurale me banesë njëdy katëshe, ku ndërthurën banesat autoktone ekzistuese me ndërtimet e reja të realizuara pas viteve '90. Zgjerimi i fshatit përtej bërthamës tradicionale ka sjellë rritje të sipërfaqes së ndërtuar dhe të numrit të konsumatorëve potencialë për furnizim me ujë të pijshëm.

Aktualisht, **fshati Bukaq nuk disponon një rrjet funksional të ujësjellësit**. Banorët furnizohen kryesisht:

- me **puse individuale** (puseta të hapura në oborret e banesave), ose
- me **linja individuale lidhjeje** nga rrjeti i ujësjellësit të qytetit Kavajë, të realizuara rast pas rasti, pa një projekt të unifikuar dhe pa kontroll të plotë teknik.

Këto mënyra furnizimi nuk garantojnë:

- **sasi të mjaftueshme** të ujit, veçanërisht në periudhat e verës dhe orareve të pikut,
- **cilësi të kontrolluar higjieno-sanitare** sipas kërkesave të standardeve në fuqi,
- **presion të qëndrueshëm** në rubinet për të gjitha banesat, veçanërisht për ndërtimet e reja të vendosura në kuota më të larta ose më larg burimeve ekzistuese.

Në disa raste, gjatë viteve të kaluara janë kryer **investime të pjesshme emergjente**, duke ndërtuar linja të veçuara tubacionesh në vazhdim të linjave ekzistuese ose duke bërë lidhje sporadike për konsumatorë të veçantë. Këto ndërhyrje:

- nuk janë bazuar në një **projekt të plotë hidraulik**,
- nuk kanë parashikuar **rritjen e kapaciteteve** të tubacioneve kryesore,
- nuk kanë marrë në konsideratë **rritjen e numrit të banorëve** dhe zgjerimin e zonës së banuar,
- nuk sigurojnë **rrjet të strukturuar** me nënndarje, unaza dhe pika kontrolli.

Si rezultat, **rrjeti aktual (i fragmentuar) nuk arrin të përmbushë kërkesat** për furnizim të qëndrueshëm, të sigurt dhe të pandërprerë me ujë të pijshëm 24 orë në ditë.

2. Arsyetimi i nevojës për investim

Problematika e furnizimit me ujë në fshatin Bukaq lidhet me faktorë të përgjithshëm kombëtarë dhe vendorë, ndër të cilët:

1. **Rritja e konsumit ditor për ujë** për shkak të përdorimit të pajisjeve të reja elektro-shtëpiake (lavatrice, lavastovilje, sisteme kondicionimi etj.), çka ka rritur ndjeshëm normën mesatare të shpenzimit për banor.
2. **Mospërputhja e zhvillimit urban me infrastrukturën ekzistuese** – ndërtime të reja pas viteve '90 janë zgjeruar jashtë perimetrit fillestar, shpesh në zona të paplanifikuara për intensitet të lartë popullsisë, pa u shoqëruar paralelisht me zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit.
3. **Mungesa e një rrjeti të dedikuar dhe të standardizuar** në vetë fshatin Bukaq, që të marrë parasysh normat bashkëkohore të furnizimit dhe perspektivën e zhvillimit të zonës.
4. **Varësia nga zgjidhje individuale** (puse, linja private), që nuk janë të qëndrueshme afatgjatë dhe nuk garantojnë cilësi, siguri dhe monitorim të centralizuar të ujit të pijshëm.

Zhvillimi i planifikuar i zonës kërkon domosdoshmërisht që të **shoqërohet me infrastrukturë të plotë të Ujësjellës-Kanalizimeve**, për të respektuar normativat kombëtare dhe për të siguruar standard minimal jetese për banorët.

3. Qëllimi i projektit të rikonstruksionit

Ky projekt synon:

- **Ndërtimin e një rrjeti të ri të plotë të ujësjellësit** për fshatin Bukaq dhe zonat e reja përreth, të dimensionuar sipas normativës për kërkesë maksimale ditore **150 l/ditë për banor**,
- **Sigurimin e furnizimit me ujë 24 orë në ditë**, me prurjen dhe presionin e kërkuar gjatë gjithë vitit,
- **Përballimin e flukseve maksimale të konsumit dhe krijimin e një sistemi të qëndrueshëm hidraulik**, që minimizon humbjet teknike dhe mundëson menaxhimin efikas të rrjetit,
- **Zëvendësimin e zgjidhjeve individuale** me një sistem të centralizuar, të kontrolluar dhe të monitorueshëm, që garanton cilësinë e ujit të pijshëm sipas standardeve.

Investimi në rikonstruksionin dhe ndërtimin e rrjetit të ri të ujësjellësit në fshatin Bukaq është, pra, një domosdoshmëri teknike, sociale dhe mjedisore, që synon:

- rritjen e cilësisë së jetës së banorëve,
- uljen e riskut nga përdorimi i ujit jo të kontrolluar,
- krijimin e kushteve për një zhvillim të qëndrueshëm të zonës në përputhje me dokumentet e planifikimit.

Impakti në kontrata të reja: në fshatin Butaq nuk kemi kontrata dhe referuar të dhënave për numrin e popullsisë pritet të hapen **670 kontrata të reja**.

Objekti 3: Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të fshatrave të Njësisë Administrative Fushe-Kuqe dhe Thumane, Bashkitë Kurbin dhe Krujë



**UJËSJELLËS
KANALIZIME**
RAJONI DURRËS

Adresa: L.17, Rr. Dëshir Peza e-mail: info@ukdurrës.al

Vlerë 1,498,549,910.51 leke me tvsh

Projekti "Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të fshatrave të Njësisë Administrative Fushë-Kuqë dhe Thumanë, Bashkitë Kurbini dhe Krujë" paraqet një domosdoshmëri për përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm në zonat rurale që aktualisht përballen me vështirësi të theksuara në garantimin e sasisë, cilësisë dhe vazhdimësisë së furnizimit.

Rrjeti ekzistues është ndërtuar para viteve '90 dhe paraqet **amortizim të theksuar, humbje të mëdha teknike dhe administrative**, si dhe **mungesë të segmentëve funksionalë të shpërndarjes**. Pjesa më e madhe e linjave janë jashtë parametrave hidraulikë, ndërsa lidhjet e shumta informale kanë sjellë **rritje të ujit pa të ardhura**.

Kjo situatë ndikon drejtpërdrejt në:

- pamundësinë për të garantuar furnizim të qëndrueshëm 24 orë në ditë;
- uljen e presionit dhe cilësisë së ujit në pika të shumta të rrjetit;
- kosto të larta operative për shkak të humbjeve dhe mirëmbajtjeve të shpeshta;
- pamundësi për matje reale të konsumit dhe faturim të saktë ndaj përdoruesve.

Gjithashtu, gjatë viteve të fundit, zonat e Fushë-Kuqes dhe Thumanës kanë njohur **rritje të shpejtë të popullsisë** për shkak të **zhvendosjeve demografike, ndërtimit të banesave të reja dhe zhvillimit të aktiviteteve tregtare**, duke e rritur ndjeshëm kërkesën për furnizim me ujë të pijshëm.

Rikonstruksioni i rrjetit ekzistues dhe ndërtimi i linjave të reja do të:

- reduktojë ndjeshëm humbjet teknike dhe administrative të ujit;
- ulë nivelin e ujit pa të ardhura dhe do të përmirësojë eficiencën ekonomike të shoqërisë;
- sigurojë furnizim të vazhdueshëm dhe me parametra të qëndrueshëm për banorët e zonës;
- garantojë cilësi dhe presion optimal të ujit në përputhje me standardet e furnizimit publik

Ky investim përbën një ndërhyrje të domosdoshme për **modernizimin e sistemit të ujësjellësit** në këto zona dhe për **përmirësimin e performancës financiare** përmes reduktimit të ujit pa të ardhura dhe rritjes së të ardhurave të faturueshme.

1. Ndërtimi i linjës së dërgimit

- Ndërtimi i linjës së dërgimit nga tub çeliku Ø700 mm (Depo 2000 m³ – Fshati Likmetaj)

2. Depo akumulimi

- Ndërtimi i depos së re 2000 m³ në Likmetaj

3. Ndërtimi i linjës kryesore të shpërndarjes

- Linja kryesore e rrjetit të shpërndarjes të ujësjellësit të Fushë Kuqes
- Linja kryesore e rrjetit të shpërndarjes të ujësjellësit të Thumanës
- Linja kryesore e rrjetit të shpërndarjes të ujësjellësit të Gëzmajës



**UJËSJELLËS
KANALIZIME**
RAJONI DURRËS

Adresa: L. 17. Rr. Dalip Peza e-mail: info@ukdurrës.al

4. Ndërtimi i linjave të shpërndarjes

Linja e rrjetit të shpërndarjes të ujësjellësit të Fshatit Paok

- Linja e rrjetit të shpërndarjes të ujësjellësit të Fshatit Gramëz Zona Nr. 2
- Linja e rrjetit të shpërndarjes të ujësjellësit të Fshatit Arfitrak
- Linja e rrjetit të shpërndarjes të ujësjellësit të Fshatit Likujan i Ri
- Linja e rrjetit të shpërndarjes të ujësjellësit të Fshatit Bushnesh i Ri
- Linja e rrjetit të shpërndarjes të ujësjellësit të Fshatit Sukth Vendres
- Linja e rrjetit të shpërndarjes të ujësjellësit të Fshatit Gramëz Zona Nr. 3
- Linja e rrjetit të shpërndarjes të ujësjellësit të Fshatit Gramëz Zona Nr. 4

5. Qëllimi i projektit të rikonstruksionit

Projekti në total përfshin rikonstruksionin e rrjetit të ujësjellësit për fshatrat e sipërcituar. Sipas mënyrës së projektimit investimi mund të copëzohet në dy faza, me qëllim që të krijohet mundësia për financim. Qëllimi kryesor i fazës së parë mbetet shkëputja e 5-daljeve ekzistuese përgjatë transmisionit DN 700 dhe ndërtimi i depos së re që do furnizohet nga një pikë dalje nga tubacioni kryesor.

Impakti kryesor i këtij investimi mbetet në **reduktimin e humbjeve teknike me rreth 3-5%** përgjatë transmisionit DN 700 të burimit Fushë Kuqe, burimi kryesor i furnizimit me ujë të qytetit të Durrësit. Me reduktimin e humbjeve nga transmisioni do të thotë më shumë ujë për zonën e qytetit Durrës apo për të ndimuar në përballimin e kërkesave të zonave turistike si ajo e Marinës.

Objekti 4: Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të fshatrave të Njësisë Administrative Manëz, Bashkia Durrës.

Vlerë 793,469,279.00 leke me tvsh

1. Hyrje dhe problematika e përgjithshme

Është e njohur problematika e garantimit të sasisë së ujit që të mbulojë zonat e banuara ekzistuese dhe ato të ndërtuara pas viteve '90. Pak zona kanë arritur ende ta zgjidhin plotësisht çështjen e furnizimit me ujë të pijshëm 24 orë në ditë. Situata aktuale nuk vjen si pasojë e mungesës së ujit në burimet natyrore, por kryesisht si rezultat i faktorëve të mëposhtëm:

a. Rritja e normës ditore për ujë pas viteve '90, për shkak të përdorimit të pajisjeve të reja elektro-shtëpiake.



**UJËSJELLËS
KANALIZIME**
RAJONI DURRËS

Adresa: L. 17. Rr. Dalip Peza e-mail: info@ukdurrës.al

- b. Amortizimi i rrjeteve ekzistuese të ndërtuar para viteve '90.
- c. Lëvizja demografike dhe rritja e popullsisë në zona të caktuara.
- d. Vendosja e banorëve në zona të paplanifikuara për intensitet të lartë populsië.
- e. Humbjet teknike në rrjet, për shkak të amortizimit, shpërthimeve dhe lidhjeve të pakontrolluara.
- f. Lidhjet e paligjshme dhe faturimi aforfe, të cilat rrisin artificialisht humbjet e ujit.
- g. Zhvillimi i planifikuar urban dhe rural, i cili kërkon domosdoshmërisht mbulim me infrastrukturë Ujësjiellës-Kanalizime.
- h. Ndërtimet e reja në kuadër të rindërtimit nga tërmeti i vitit 2019, të cilat kanë shtuar ndjeshëm numrin e konsumatorëve dhe shtrirjen e rrjetit.

2. Gjendja ekzistuese në zonën e Manzës

Zonat e projektit përfshijnë ndërtesa ekzistuese dhe ndërtime të reja, formale dhe informale, si dhe banesa të ndërtuara ose rindërtuar pas tërmetit të vitit 2019. Këto kanë rritur sipërfaqen e mbulimit me rrjet shpërndarës dhe numrin e konsumatorëve që duhet të furnizohen në mënyrë të sigurt dhe të qëndrueshme.

Linja ekzistuese e dërgimit furnizohet me orar nga linja e Çelikut Ø700 mm e Fushë Kuqes. Kjo linjë furnizon depot e fshatrave Shkallë, Kuçok, Antenë, Manzë fshat dhe Radë, por: përgjatë saj janë kryer ndërhyrje të paligjshme, në disa seksione linja e dërgimit përdoret pjesërisht edhe si linjë shpërndarjeje, kjo situatë pengon mbushjen e plotë të depove dhe ul ndjeshëm eficiencën e sistemit.

Për shkak se depot nuk vendosen plotësisht në funksion me kapacitetin e tyre të projektuar, rrjeti i shpërndarjes nuk arrin të plotësojë nevojat për ujë të banorëve, si në sasi ashtu edhe në cilësi (presion i ulët, furnizim me orar, humbje të larta).

Gjatë viteve të fundit janë realizuar vetëm investime të pjesshme për përmirësimin e situatës, kryesisht në kuadër të emergjencës: ndërtim rrjetesh tubacionesh dhe kolektorësh në vazhdim të linjave ekzistuese, instalim matesash në disa zona, sidomos në lagje të ndërtuara pas tërmetit të vitit 2019,

por këto nuk kanë përfshirë rritjen e kapaciteteve të linjave kryesore të dërgimit dhe as një ristrukturim të plotë të rrjetit.

Në fshatrat Radë, Kamas, Manzë fshat, Kuçok, Lagjia e Re, Shkallë, Borçe dhe Kullë ekziston pjesërisht një rrjet shpërndarje për furnizim me ujë, por: një pjesë e rrjetit është shumë i vjetër dhe i amortizuar, pjesa tjetër është relativisht e re, ndërtuar vitet e fundit, por pa u integruar në një skemë të plotë hidraulike, linja e dërgimit dhe degëzimet e saj drejt depove të fshatrave përdoren nganjëherë si linja shpërndarjeje, duke shkaktuar ngatërime hidraulike dhe humbje të mëdha uji në linjën kryesore të Çelikut Ø700 mm.

Problemi kryesor për fshatrat e zonës së Manzës lidhet me: linjën e dërgimit nga tubi Ø700 mm për furnizimin e depove, ku ka ndërhyrje të paligjshme, mbulimin e gjithë fshatrave me linja



shpërndarjeje të pakontrolluara, prezencën e matesave vetëm pjesërisht në zonat e reja të ndërtuara pas tërmetit 2019, pamundësinë për të menaxhuar humbjet dhe për të siguruar presion të qëndrueshëm.

3. Gjendja teknike e disa elementeve kryesore

Fshatrat Amarth dhe Hamallaj kanë investime gjatë 5 viteve të fundit në linja dërgimi, depo 1000 m³ dhe rrjet shpërndarës – këto konsiderohen në gjendje më të mirë teknike dhe mund të integrohen në skemën e re të furnizimit.

Fshati Radë furnizohet nga depo Radë 200 m³, e cila furnizohet nga linja e dërgimit me tub PE Ø160 mm që lidhet në Manzë, në pusetën e komandimit me tubin e Gizes Ø200 mm. Depoja paraqitet në gjendje të mirë pune dhe konsiderohet element i vlefshëm për t'u ruajtur në projektin e ri.

4. Arsyetimi i nevojës për rikonstrukcion të rrjetit

Nga analiza e situatës, del e qartë se:

Rrjetet ekzistuese të shpërndarjes janë të fragmentuara, të amortizuara ose të mbingarkuara dhe nuk korrespondojnë me nivelin aktual të zhvillimit të zonës dhe rritjes së konsumatorëve.

Linja kryesore e dërgimit nga Ø700 mm dhe degëzimet e saj janë të kompromentuar nga ndërhyrje të paligjshme, përdorim i përzier për dërgim dhe shpërndarje, humbje të mëdha teknike dhe vështirësi në menaxhim.

Investimet e pjesshme të deritanishme kanë qenë të karakterit emergjent dhe nuk janë mbështetur në një projekt të integruar hidraulik, të aftë të sigurojë furnizim 24 orë, me prurje e presion sipas normativave.

Rritja e konsumit për banor (normë ditore 150 l/ditë për banor në kërkesë maksimale) dhe shtimi i ndërtimeve pas tërmetit 2019 kërkon ridimensionim të të gjithë sistemit.

Për këto arsye, lind nevoja që të projektuar e të ndërtohet një rrjet i ri i ujësjellësit, i strukturuar qartë në linja dërgimi dhe linja shpërndarjeje, të mbahen vetëm depot ekzistuese dhe linjat e reja që përmbushin kriteret hidraulike dhe konstruktive, të realizohen rilogaritje të plota të prurjeve, presioneve dhe diametrave të tubacioneve, në mënyrë që të bëhet e mundur furnizimi me ujë 24 orë në ditë, siguria e prurjes dhe presionit të kërkuar në të gjitha fshatrat e zonës së Manzës, ulja e humbjeve teknike dhe jo-teknike (përmes ndarjes së qartë dërgim/shpërndarje, matjes, menaxhimit dhe reduktimit të lidhjeve të paligjshme).



Përqendrim i burimeve në elementët "çelësi" (linja Ø700 mm → pusëtë; linja dërgimi për fshatra me numër më të madh konsumatorësh) garanton efekt të menjëhershëm në mbushjen e depove dhe furnizimin 24h me presion adekuat.

Reduktim i humbjeve dhe i rrjedhës së jashtme të ujit duke vendosur valves dhe matje në pusetat kyçe; kjo mund të ulë treguesin e vjedhjeve dhe lidhjeve të paligjshme.

Kosto-efikasitet — me ndërhyrje selektive arrijmë rezultate të matshme në furnizim pa angazhuar menjëherë investime të mëdha për rrjetin e plotë të shpërndarjes që do të kërkonte gjithashtu zëvendësime masive të tubacioneve dhe depove.

Modularitet — pas arritjes së stabilitetit hidraulik dhe reduktimit të humbjeve, mund të vijojë faza e dytë për zgjerimin e rrjetit shpërndarës dhe zëvendësimin e pjesëve të amortizuara.

Objekti 5: "Rikonstruksion i Rrjetit të Ujësjetës të Fshatit të Njësisë Administrative Rashbull, Bashkia Durrës"

Vlerë 385,996,733.31 leke me tvsh

Gjendja ekzistuese e ujesjellsave te zonave

Është e njohur problematika e garantimit të sasisë së ujit që të mbulojë zonat e banuara ekzistuese dhe ato të ndertuara pas viteve '90. Janë pak zona që e kanë zgjidhur këtë problematike për furnizimin me ujë të pijshëm 24-ore në ditë. Kjo situatë vjen jo për shkak të mungesës së ujit në burimet tona natyrore, por si pasojë e disa faktorëve si më poshtë:

- a. Rritja e normes ditore për ujë pas viteve '90 me përdorimin e paisjeve të reja elektroshtëpiake.
- b. Amortizimi i rrjeteve ekzistues të ndërtuar para viteve '90.
- c. Levizja demografike.
- d. Vendosja e banoreve në zona të pa planifikuara për intesitet të lartë të popullsisë.
- e. Humbjet teknike në rrjet.
- f. Lidhjet e paligjshme ose faturimi aforfe rrit artificialisht humbjet e ujit

Objekti i kësaj veprë teknike është hartimi i rrjetit të furnizimit me ujë për fshatin Romanat. Ndërhyrja në këtë zonë bëhet për të:

- Furnizuar me ujë zonën e banuar.
- Përmirësuar orarin e furnizimit me ujë në 24 orë,
- Përmirësimin e sasisë së ujit për frymë,
- Përmirësimin e cilësisë së ujit,
- Zëvendësuar linjat ekzistuese të amortizuara

Projektuesi ka marrë në konsideratë gjendjen ekzistuese dhe ka kryer azhurnimet dhe matjet topografike të nevojshme. Janë identifikuar të gjithë ndertesat, tipologjia e tyre, numri i kateve dhe numri i konsumatoreve në ndertese.



**UJËSJELLËS
KANALIZIME**
RAJONI DURRËS

Adresa: L. 17, Rr. Dalip Peza e-mail: info@ukdurrës.al



Arsyetimi i nevojës për rikonstruktion të rrjetit

Projekti i hartuar me qëllim plotësimin e kërkesave që ajo ka për furnizimin me ujë të konsumatoreve 24-ore, menaxhimin sa më efikas me kosto të ulët të gjithë rrjetit shpërndarës.

Pas llogaritjeve hidraulike dhe kërkesës për ujë të popullatës rezultoi se kapaciteti përpunues i depoz është 200 m³. Nga vëzhgimi i territorit nuk ka hapësirë për të ndërtuar depoz në një pozicion tjetër dhe komunikimi me zyren teknik ete UKD u vendos që depoz e re të vendoset në kodrin mbi fshat për të mbuluar të gjithë zonën me ujë.

Ky rrjet shpërndarës kanë si pike furnizimi Depo e Re 200 m³ që furnizohet me ngritje mekanike nga stacionet e pompimit Ishem. Nga depoz del një tub PE 100RC, DN/OD 160 mm PN 16bar e cila është e pajisur me saraçineska tip shpigël për manovrimin e linjave të shpërndarjes. Rrjeti shpërndarës është konceptuar në dy zona furnizimi me ujë. Për fshatin Romanat në projekt parashikohet pastrim i puseve ekzistuese, vendosja e pompave zhytëse në puse, rikonstruktion i godinës eksistuese me qëllim përdorimi si dhomë manovrimi, ndërtim i linjesë dërgimit me tub PE 100 RC PN 16-25 bar DN/OD 160mm, ajruer, ndërtimi i depoz se re V=200m³ mbi fshat, ndërtim e linjave të shpërndarjes nga depoz e re, saraçineskat Tip Shpigël, kolektorët 5-7 dalje dhe box individual.

Duke qënë se linjat kalojnë në rrugë të asfaltuar dhe rrugë me beton, gjatë gërmimit të kanaleve dheu i gërmuar do të largohet dhe mbushja e kanalit do të bëhet me çakull për të përmirësuar parametrat e rrugës dhe evituar dëmtimet.

Në linjat që kalojnë në rrugë të paasfaltuar, gjatë gërmimit të kanaleve dheu i gërmuar do të largohet pjesërisht dhe mbushja e kanalit do të bëhet me me çakull mali dhe stabilizant për të përmirësuar parametrat e rrugës.

Rrugët e asfaltuara dhe me beton do të kthehen në gjendjen fillestare me asfalt dhe beton. Në këtë njësi administrativë matësat e ujit parashikohen të jenë të thjeshtë.

Projekti i njësisë administrativë Rashbull është jetik për banorët e zonës pasi rrjeti i ujesjellesit është i amortizuar dhe pompimi i ujit nga pusehëpimet në lumin Erzen është me kosto të lartë energjie elektrike. Kjo zonë ka një depoz 60m³ e cila nuk ka kuotë, nuk përballon kapacitetet e furnizimit me ujë për nevojat e popullatës dhe normave aktuale të furnizimit.

Këto projekte ka këto anë pozitive.

1. Furnizimin me ujë të banorëve rezidentë dhe bizneseve.
2. Në thjeshtësinë e veprës, si në konstruktimin e saj, ashtu edhe në funksionimin.
3. Mbulimi i plotë me rrjet të furnizimit me ujë për zonat e njësive administrative.
4. Rikonstruktion/ndërtim i linjave, depoz, lidhja 100% e popullatës që jeton në zonën.
5. Garantimi i furnizimit me ujë për të gjitha fshatrat, vendosja e matësve për çdo lidhje, furnizimi me 24 ore ujë, me presionin e nevojshëm dhe cilësinë e ujit sipas standardeve të legjislativës Shqiptar në fuqi.
6. Ndërtimi e skemave hidraulike të qëndrueshme për një periudhë afatgjatë 50-vjeçare.



**UJËSJELLËS
KANALIZIME
RAJONI DURRËS**

Adresa: L.17.Rr.Dalip Pezë e-mail: info@ukdurrës.al



Objekti 6: "Rikonstruksion i Rrjetit të Ujës jellës të Fshatrave të Njësisë Administrative Maminas, Bashkia Shijak"

Vlerë 523,794,496.83 leke me tvsh

Objekti i kësaj vepre teknike është hartimi i rrjetit të furnizimit me ujë për fshatrat Bodinak, Metalle, Vlashaj, Karpen, Koxhaj dhe Borake.

Ndërhyrja në këtë zonë bëhet për të:

- Furnizuar me ujë zonën e banuar.
- Përmirësuar orarin e furnizimit me ujë në 24 orë,
- Përmirësimin e sasisë së ujit për frymë,
- Përmirësimin e cilësisë së ujit,
- Ulur humbjet në rrjet
- Zevendesuar linjat ekzistuese të amortizuara

Zonat e projektit kryesisht janë zona ekzistuese dhe me ndertime të reja përreth fshatrave autokton duke rritur sipërfaqen e mbulimit me rrjet ujës jellës dhe numrin e konsumatorëve. Rrjeti i ekzistues i shpërndarjes nuk arrin të plotësojë nevojën për furnizim me ujë për këta banorë me sasinë dhe cilësi të duhur pasi aty me parë janë bërë vetëm investime të pjesëshme për të përmirësuar gjendjen e emergjencës.

Jane ndertuar rrjete tubacionesh në vazhdim të rrjeteve ekzistuese, pa rritur kapacitetin e tubacioneve prandaj lind nevoja për ndërtimin e një rrjeti shpërndarës tërësisht të ri që të trajtojë të gjithë zonën të plote me normat e reja që të bëjë të mundur furnizimin me ujë 24 orë, me prurjen dhe presionin e kërkuar për të gjithë vitin dhe të përballojë fluksin e pushuesve sezonale, me sasinë e ujit që është llogaritur sipas normativës me kërkesë maksimale ditore 150 l/dite për banor.

Si burim i furnizimit të skemës janë puse-shpimet e Ures së Gjoles të cilat nëpërmjet një tubacioneve perkatese dërgon ujë në depot Bodinak, Vlashaj dhe Shilore. Furnizimi me ujë i fshatrave të njësisë administrative Maminas dhe Xhafzotaj pjesë e këtij projekti do të furnizohen nga depot ekzistuese.

Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë të fshatrave do të jetë me vetërrjedhje, nga depot ekzistuese $V=2000m^3$, $V=150m^3$ të cilat furnizohen nga stacioni pompimit Ura e Gjoles.

Sistemi i rrjetit shpërndarës është parashikuar të ndërtohet me tubacione prej polietileni PE 100 RC (PN 10-16 bar), me bashkim me manikota me elektrofuzion.



UJËS JELLËS
KANALIZIME
RAJONI DURRËS

Adresa: L.17.Rr.Dalip Peci e-mail: info@ukdurre.al

Tubacioni do të trasohet nëntokë në thellësinë $h = l [m] + Dj [m]$. Në nyjet e bashkimit me pusete H₁ kanalit 5-10 m para pusetes duhet të rakordohet me thellesine e pusetes.

Para fillimit të punimeve, kontraktori duhet të kontrollojë mirë kushtet gjeologjike të terrenit si dhe të verifikojë kuotat e dhëna në projekt, me kuotat faktike të terrenit.

Duhet të përforcohet mirë, bazamenti i të gjitha pusetave.

Për fshatrat në studim të njësisë Administrative Maminas dhe Xhafzotaj është parashikuar që të mos ndryshohet skema aktuale e furnizimit me uje.

Aktualisht dy stacione pompimi janë të lidhur në tubin PE 500 mm i linjes së dergimit nga puseshpimet e Ures Gjoles deri në Depo Relacion Teknik "Rikonstruksion i ujësjellësit të fshatrave Njesia Administrative Maminas, Bashkia Shijak 33 Shilore 2000m³ të qytetit të Shijakut.

Në projekt parashikohet që të ndërtohet rrjeti shpërndarës i fshatrave, kolektoret e shpërndarjes dhe matesat për të menaxhuar konsumin e ujit. Zona nuk ka afër mundësi të furnizimit me ujë me vetërrjedhje.

Projekti i njesise administartive Maminas dhe Xhafzotaj ka rëndësi të madhe për furnizimin me uje të qytetit të Shijakut. Keto fshatra marrin uje direkt në linje dergimi PE 500mm që furnizon depon Shilore. Keto fshatra kanë depo dhe stacione pompimi të reja të cilat nuk janë në punë. Menyra aktuale e furnizimit me uje ka efekt të madh në humbjet e ujit të prodhuar nga puseshpimet e Ures së Gjoles

Keto projekte ka këto anë pozitive.

1. Furnizimin me ujë të banorëve dhe bizneseve.
2. Në thjeshtësinë e veprës, si në konstruktimin e saj ashtu edhe në funksionimin.
3. Mbulimi i plotë me rrjet të furnizimit me uje për fshatrat.
4. Rikonstruksion i linjave, lidhja 100% e popullatës që jeton në zonë.
5. Garantimi i furnizimit me uje, vendosja e matesave për çdo lidhje, furnizimi me uje 24-ore, me presionin dhe cilësi sipas standarteve të legjislacionit Shqiptar në fuqi.
6. Ndertimi e skemave hidraulike të qëndrueshme për një periudhë afatgjatë 50-vjeçare.

Objekti 7: "Projekti i Rrjeteve Inxhinierike FU dhe KUN nga kufiri pronës deri të Pika e Lidhjes, Investim Marina"

Vlera: 28,880,000 lekë pa t.v.sh

Në përputhje me detyrimet e përcaktuara në kuadrin ligjor dhe aktet nënligjore (VKM-të në fuqi), shoqëria e ujësjellës-kanalizimeve ka përgjegjësinë të sigurojë furnizimin me ujë deri në



**UJËSJELLËS
KANALIZIME**
RAJONI DURRËS

Adresa: L.17.Rr.Dalip Peza e-mail: info@ukidurres.si

kufirin e pronës së konsumatorit. Ky parim zbatohet edhe për subjektet e kategorizuara si **investitorë strategjikë**, të cilët kërkojnë lidhjen me infrastrukturën hidrike projektin me objekt "Durrës Yachts & Marina". Me shkresën nr.6594 prot., datë 17.11.2025 i është dërguar kërkesa për miratim fondi AKUK dhe në buxhetin e vitit 2026 nuk është miratuar fond, për të cilën propozohet të zbatohet me fonde të shoqërisë.

Përmes komunikimeve të zhvilluara me institucionet përgjegjëse, është konfirmuar se realizimi i kësaj lidhjeje dhe ofrimi i kapaciteteve të nevojshme të furnizimit do të kryhen **përmes investimeve të vetë Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Durrës**, në respektim të kërkesave ligjore, standardeve teknike dhe angazhimeve institucionale.

Ky investim është i domosdoshëm për:

- garantimin e furnizimit të sigurt dhe të qëndrueshëm me ujë për investitorët strategjikë;
- përmbushjen e detyrimeve ligjore të shoqërisë;
- mbështetjen e zhvillimeve të mëdha ekonomike në zonën Marinë-Durrës;
- sigurimin e kushteve të barabarta të aksesit në infrastrukturë për të gjithë përdoruesit.

Investimi do të realizohet në bazë të Marrëveshjes Kuadër përkatësisht të projektit miratuar me **Ligjin 79/2022, Neni 11, Seksioni 11.1 Infrastruktura, Pika 11.1 "Qeveria Shqiptare, vetëm me koston dhe shpenzimet e saj, nëpërmjet institucioneve qeveritare përgjegjëse, do të garantojë zhvillimin e infrastrukturës së shërbimeve dhe furnizimin e shërbimeve komunale (ujë i pijshëm dhe jo i pijshëm), energji elektrike, rrugët, rrjeti i kanalizimeve), deri në kufijtë e jashtëm të sheshit të projektit në sasi, cilësi dhe kapacitet të tillë (duke përfshirë çdo përmirësim të nevojshëm) siç përcaktohet në detaje në aplikimin e Investitorit Strategjik për Leje Zhvillimi ("Infrastruktura Bazë") deri në pikat e specifikuara të lidhjes".**

Referuar takimeve të përbashkëta me stafin e investitorit të këtij projekti, me shkresën nr.345/2 prot., datë 02.02.2026 na dërgohet "Projekti teknik për pikën e lidhjes FU dhe KUN", sipas të cilës trajtohet zgjidhja teknike nga pika e lidhjes dhe pika e shkarkimit të përcaktuara nga ana e SHRUKD-së, deri në kufirin e pronës.

Përfitimet e realizimeve të projekteve

1.Ulje e humbjeve të ujit në rrjet me rreth 3-5 %

Me rikonstruksionin e linjave të dërgimit dhe rrjetit shpërndarës, zëvendësimin e tubacioneve të amortizuara dhe eliminimin e ndërhyrjeve të paligjshme, pritet një ulje e dukshme e humbjeve fizike të ujit. Reduktimi i humbjeve në intervalin 3-5 % përmirëson bilancin hidrik të zonës, bën të mundur që një pjesë më e madhe e ujit të prodhuar të shkojë realisht te konsumatori dhe ul nevojën për prodhim/pompim shtesë. Qëllimi kryesor shtimi i sasisë së ujit për qytetin e Durrësit dhe zonat bregdetare.

Rritje e kapacitetit të furnizimit dhe mbulimit me shërbim



**UJËSJELLËS
KANALIZIME
RAJONI DURRËS**

Adresa: L.17.Rr.Dalip Peza e-mail: info@skudurres.nl

Duke pasur më pak humbje në rrjet dhe një skemë të qartë dërgimi-shpërndarjeje, kapaciteti ekzistues i burimit dhe i linjave shfrytëzohet më mirë. Kjo bën të mundur: furnizimin e një numri më të madh banorësh brenda të njëjtit sistem, zgjerimin e mbulimit në zona që sot furnizohen pjesërisht ose me orar, krijimin e kushteve për lidhje të reja pa rrezikuar uljen e presionit për konsumatorët ekzistues.

Rritje e numrit të kontratave të rregullta me konsumatorët

Përmirësimi i cilësisë së shërbimit (presion më i qëndrueshëm, furnizim më i besueshëm, më pak defekte) nxit formalizimin e lidhjeve: banorët që furnizohen sot me zgjidhje individuale (puse, linja private) ose me lidhje jo të rregullta kanë më shumë interes të lidhen me rrjetin, operatori ka mundësi të shtojë numrin e kontratave aktive dhe të kontrollojë më mirë konsumin.

Kjo rrit bazën e konsumatorëve të faturuar dhe ul hapësirën për lidhje të paligjshme.

Sipas numrit të popullsisë dhe reduktimi i humbjeve administrative pritet të shtohen me rreth **1100 kontrata të reja.**

Përmirësim i ndjeshëm i cilësisë së furnizimit me ujë

Ndërhyrjet në linjat kryesore të dërgimit dhe në rrjetet shpërndarëse sjellin presion më të qëndrueshëm gjatë gjithë ditës, furnizim me orare më të gjata, me synim 24 orë në ditë kur lejojnë kapacitetet, reduktim të problemeve me ajrosje të linjave, shpërthime dhe mbetje sedimentesh.

Për konsumatorin final kjo përkthehet në një shërbim më cilësor, të parashikueshëm dhe të besueshëm.

Rritje e sigurtisë së furnizimit në periudhat e pikut

Duke rregulluar linjën e dërgimit nga tubi Çeliku Ø700 mm dhe duke strukturuar qartë linjat e dërgimit për në depo, sistemi bëhet më i qëndrueshëm në: periudha vere, ditë dhe orare piku (mëngjes-darkë).

Rrjeti i dimensionuar sipas normës 150 l/ditë për banor dhe me humbje të reduktuara garanton furnizim më të sigurt edhe kur kërkesa rritet.

Rritje e eficiencës energjetike të sistemit të furnizimit

Ulja e humbjeve në rrjet do të thotë: më pak ujë i humbur për çdo m³ të prodhuar/pompuar, presionet mund të mbahen në nivele optimale pa nevojë për rritje artificiale të tyre.

Kjo çon në ulje të konsumit të energjisë elektrike për pompim, ulje të kostove operative për operatorin dhe një sistem më të qëndrueshëm financiarisht.

Reduktim i ndërhyrjeve emergjente në rrjet

Rikonstruksioni i linjave të dëmtuara dhe ndarja e qartë e linjave të dërgimit nga ato të shpërndarjes ulin: shpërthimet e tubacioneve, defektet e shpeshta në pika të dobëta, ndërprerjet e paplanifikuara të furnizimit.



**UJËSJELLËS
KANALIZIME
RAJONI DURRËS**

Adresa: L.17, Rr. Daliq Peza e-mail: info@ujdurrës.al

Kjo hën që shërbimi i furnizimit me ujë të jetë më i qëndrueshëm dhe stafi i mirëmbajtjes të fokusohet më shumë në kontroll parandalues se sa në riparime emergjente.

Rritje e arkëtimeve nga shitja e ujit

Me rritjen e numrit të konsumatorëve të lidhur në mënyrë të rregullt, uljen e humbjeve fizike, reduktimin e lidhjeve të paligjshme, operatori arrin të rrisë sasinë e ujit të faturuar dhe të arkëtuar realisht. Kjo sjell një efekt pozitiv në financat e shoqërisë së ujësjellësit dhe krijon mundësi për më shumë investime dhe mirëmbajtje të planifikuar.

Rritje e jetës së rrjetit të furnizimit me ujë

Investimi në linjat e dërgimit dhe në rrjetet shpërndarëse zëvendëson elementët e amortizuar me tubacione dhe pajisje të reja, sipas standardeve bashkëkohore. Kjo zgjat jetëgjatësinë e rrjetit, ul nevojën për riparime të shpeshta, garanton një infrastrukturë më të sigurt për 20-30 vitet e ardhshme, në varësi të materialeve dhe kushteve të shfrytëzimit.

Sa më sipër ju paraqesim kërkesën për miratim zbatimi të objekteve të sipërcituara në mënyrë që të shikohet mundësia për financim të tyre me fonde nga Buxheti i Shtetit apo fonde të shoqërisë, duke bërë të mundur përmirësimin e furnizimit me ujë të zonave turistike dhe reduktimin e humbjeve teknike në transimion.

INVESTIMET E PARASHIKUARA 2026-FOND BUXHET SHTETI (me tvsh)

| Nr. | ZONA | INVESTIMI | Vlera ne leke | Vlera e kolaudimit ne leke | Vlera e Supervizionit ne leke | Vlera e Oponences ne leke |
|-----|--------------|---|---------------|----------------------------|-------------------------------|---------------------------|
| 1 | Durres | Rindertimi i shuarrit te presioni ne Kurate me kapacitet 800 m3, duke perfshire tubacionin e gizes DN 700 per lidhjen me linjen ekzistuese, rrugen e shorbimit dhe sistemin e monitorimit me kamera | 348,965,081 | 2,442,755 | 366,413 | 376,882 |
| 2 | Shijak | Rivendosje e 3 pompave shtytese (VSD) ne STP si dhe rehabilitimi i nderteses se pusit ne STP Fushe-Kruje | 52,134,330 | 969,698 | 145,454 | 56,305 |
| 3 | Kavaje | Pemiresimi i eficences se energjise dhe implementimi i paneleve fofovoltaike per shoqerine Durres-Cermë | 9,900,589 | 184,150 | 27,622 | 10,692 |
| 4 | Kavaje | Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të fshatrave të Njësisë Administrative Synej dhe Golem, Bashkia Kavaje | 1,490,122,886 | 10,430,860 | 1,564,629 | 1,609,333 |
| 5 | | Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Butaq, Njësia Adm.Synej Bashkia Kavaje | 75,422,003 | 1,402,849 | 210,427 | 385,604 |
| 6 | Kruje/Durres | Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të fshatrave të Njësisë Administrative Fushe-Kuqe dhe Thumanë, Bashkia Kurbën dhe Bashkia Krujë | 1,498,549,911 | 10,489,849 | 1,573,477 | 1,618,434 |
| 7 | Durres | Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të fshatrave të Njësisë Administrative Manëz, Bashkia Durres | 793,469,279 | 5,554,285 | 833,143 | 856,947 |



UJËSJIJLLËS
KANALIZIME
RAJONI DURRËS

Adresa: L. 17. Rr. Dalip Peza e-mail: info@uludurres.al

| | | | | | |
|--|--|----------------------|-------------------|------------------|------------------|
| 8 | Rikonstrukcion I Rrjetit Te Ujësjiellësit Te Fshatit Te Njësisë Administrative Rashbull, Bashkia Durrës | 385,996,733 | 2,701,977 | 405,297 | 416,877 |
| Shijak | Rikonstrukcion I Rrjetit Te Ujësjiellësit Te Fshatrave Te Njësisë Administrative Maminas, Bashkia Shijak | 523,794,197 | 3,666,561 | 549,984 | 565,698 |
| Total investime Fonde Buxhet Shteti (lekë me t.v.sh) | | 5,178,355,309 | 37,842,985 | 5,676,446 | 5,896,772 |

ANALIZA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

Ne vijim te nevojave emergjenteve si me larte permendur, eshte rishikuar analiza e shpenzimeve operative te Shoqerise , ku theksojme se plani operacional per vitin 2026 eshte projektuar ne muajin Tetor 2025. Pas mbylljes se procedurave te vitit 2025 , te cilat per arsye te ndryshme kane qene ne proces gjate 2025 , dy prej tyre jane perfunduar ne vitin 2026 , por qe realisht duhet te mbylleshin ne vitin 2025. Konkretisht procedura " Shërbim i Printimit dhe Fotokopjimit me vlerë 7,000,000 leke pa tvsh dhe procedura " Blerje materiale kancelarie dhe te ngjashme " me vlerë 7,000,000 leke pa tvsh , nuk do te prokurohen me per vitin 2026, pasi Kontratat per Furnizim me Mallra jane nenshkuar ne muajin Janar 2026 me afat 12 mujor , gje qe i ul shpenzimet operative Shoqerise me 14,000,000 leke pa tvsh. Gjithashtu procedura " Shërbim emaili " me vlerë 3,000,000 leke pa tvsh , nuk do te realizohet per vitin 2026 , pasi janë më rëndësishme per shoqerine investimet per te cilat kerkojen ndryshime.

Vlera e kursyer prej 17,000,000 lekesh i ul shpenzimet administrative operative & financiare nga 58 % ne 13 % , pra me 45% , dhe si total ulen me 0.2 %.

Si me poshte tabela me ndryshimet " Ishte " dhe " Bëhet" :

TABELA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE FINANCIARE 2026

| Nr. | Te ardhurat Totale | I PRITSHEM 2025 | PROJEKSION 2026 ISHTE | PROJEKSION 2026 BEHET | Buxhet 2026 vs Pritshem 25 11 ISHTE | Buxhet 2026 vs Pritshem 25 11 BEHET |
|-----|--|-----------------|-----------------------|-----------------------|-------------------------------------|-------------------------------------|
| 1 | Te Ardhura Uje kanalizime | 1,972,171,448 | 2,186,055,741 | 2,186,055,741 | 11% | 11% |
| 2 | Te ardhura nga Shërbime(Kontrata, Ndërrim emri, Pike Lidhje, Shitje Matesash, Azhornim rrjeti, Autobot) | 82,000,000 | 85,000,000 | 85,000,000 | 4% | 4% |
| 3 | Te ardhura kamatvonesa | 52,400,000 | 55,000,000 | 55,000,000 | 5% | 5% |

| | | | | | | |
|---|--|----------------------|----------------------|----------------------|------------|------------|
| 4 | Te adhurim te tjera(intereza bankare, kemb valutore, kom, bashkia) | 75,000,000 | 85,000,000 | 85,000,000 | 13% | 13% |
| 5 | Te ardhura amortizim grante te tjera tjeveritare | 230,000,000 | 220,000,000 | 220,000,000 | -4% | -4% |
| 6 | <i>Kerkese per Subvencionet</i> | | 31,000,000 | 14,000,000 | | |
| | TE ARDHURA TOTAL | 2,411,571,448 | 2,662,055,741 | 2,645,055,741 | 10% | 10% |
| | <i>FITIM/(HUMBJE)</i> | | <i>55,741</i> | <i>55,741</i> | | |

| | Shpenzime operative dhe financiare | I PRITSHEM 2025 | BUXHETI 2026 Ishte | BUXHETI 2026 Ishte | Buxhet 2026 vs Pritshem 25 [] ISHTE | Buxhet 2026 vs Pritshem 25 [] BUXHET |
|----|------------------------------------|----------------------|----------------------|----------------------|---|--|
| 1 | Shpenzime per materiale te para | 212,980,020 | 200,000,000 | 200,000,000 | -6% | -6% |
| 2 | Energji elektrike | 905,000,000 | 890,000,000 | 890,000,000 | -2% | -2% |
| 3 | Karburant | 44,485,450 | 50,000,000 | 50,000,000 | 12% | 12% |
| 4 | Blerje kimikate | 23,465,000 | 35,000,000 | 35,000,000 | 49% | 49% |
| 5 | Sherbime riparimesh O&M | 90,000,000 | 100,000,000 | 100,000,000 | 11% | 11% |
| 6 | Sherbime te Pergjithshme Shitje | 33,000,000 | 30,000,000 | 30,000,000 | -9% | -9% |
| 7 | Sherbime pergjith administrative | 38,000,000 | 60,000,000 | 43,000,000 | 58% | 13% |
| 8 | Shpenzime per Personelin | 850,000,000 | 985,000,000 | 985,000,000 | 16% | 16% |
| 9 | Taksa dhe tarifa vendore | 18,000,000 | 20,000,000 | 20,000,000 | 11% | 11% |
| 10 | Gjoha, Penalitete, demshperblime | 15,325,000 | 10,000,000 | 10,000,000 | -35% | -35% |
| 11 | Shpenzime interesi, financiare | 13,000,000 | 12,000,000 | 12,000,000 | -8% | -8% |
| 12 | Amortizim , zhvleresim nxjerrje JP | 280,000,000 | 270,000,000 | 270,000,000 | -4% | -4% |
| | SHPENZIME TOTAL | 2,523,255,470 | 2,662,000,000 | 2,645,000,000 | 5% | 4.8% |

Tabela e Librit te Prokurimeve 2026 (sherbime & mallra) e Rishikuar pas ndryshimeve ne zera :

| Nr. | Viti | Objekti i prokurimit | Kontratë/ Marrëveshje Kuader | Tipi i kontratës | Kategoria shpenzimeve | Kohëzgjatja e kontratës | BUXHET 2026 ishte | BUXHET 2026 Bëhe |
|-----|------|---|------------------------------|------------------|-----------------------|-------------------------|-------------------|------------------|
| 1 | 2026 | Blerje materiale dhe pajisje elektrike, vegla, pajisje mekanike | Marrëveshje Kuader | Mallra | materiale | 1 (një) vjecare | 100,000,000 | 100,000,000 |
| 2 | 2026 | Blerje materiale hidraulike | Marrëveshje Kuader | Mallra | materiale | 1 (një) vjecare | 200,000,000 | 200,000,000 |
| 3 | 2026 | Blerje materiale kompjuterike dhe informatike | Kontratë | Mallra | materiale | 1 (një) vjecare | 25,000,000 | 25,000,000 |
| 4 | 2026 | Blerje reagentesh, paisje laboratorit dhe Impjanti | Kontratë | Mallra | materiale | 1 (një) vjecare | 20,000,000 | 20,000,000 |



**UJËSJELLËS
KANALIZIME
RAJONI DURRËS**

Adresa: L. 17. Rr. Dalip Peza e-mail: info@ukdurrës.al

| | | | | | | | | |
|----|------|--|--------------------|-----------------|-------------|----------------|------------|------------|
| 5 | 2026 | Blerje materiale kancelarie dhe te ngjashme | Kontratë | Mallra | materiale | 1(një) vjecare | 7,000,000 | 0 |
| 6 | 2026 | Blerje pjese kombini per automjete, riparim, mirembajtje | Marrëveshje Kuader | Mallra | materiale | 1(një) vjecare | 40,000,000 | 40,000,000 |
| 7 | 2026 | Sigurim i automjeteve | Kontratë | Shërbime | riparim | 1(një) vjecare | 3,000,000 | 3,000,000 |
| 8 | 2026 | Blerje automjete dhe makineri | Kontratë | Mallra | admin | 1(një) vjecare | 30,000,000 | 30,000,000 |
| 9 | 2026 | Blerje materiale inerte | Marrëveshje Kuader | Mallra | materiale | 1(një) vjecare | 15,000,000 | 15,000,000 |
| 10 | 2026 | Shërbimi i përmirësimit dhe mirëmbajtjes Softëre-ii | Kontratë | Shërbime | admin | 1(një) vjecare | 15,000,000 | 15,000,000 |
| 11 | 2026 | Pastrim i kolektoreve te ujerave te ndotura | Kontratë | Shërbime | riparim | 1(një) vjecare | 60,000,000 | 60,000,000 |
| 12 | 2026 | Shërbim i printimit dhe fotokopjimit | Kontratë | Shërbime | admin | 1(një) vjecare | 7,000,000 | 0 |
| 13 | 2026 | Shërbim Kontabiliteti ,Implementim dhe Mirembajtje | Kontratë | Shërbime | admin | 1(një) vjecare | 5,000,000 | 5,000,000 |
| 14 | 2026 | Blerje kimikate | Marrëveshje Kuader | Mallra | admin | 1(një) vjecare | 35,000,000 | 35,000,000 |
| 15 | 2026 | Implementimi i shërbimit të fiskalizimit dhe mirembajtje vjetore | Kontratë | Shërbime | admin | 1(një) vjecare | 5,000,000 | 5,000,000 |
| 16 | 2026 | GIS Mirembajtje | Kontratë | Shërbime | admin | 1(një) vjecare | 9,999,000 | 9,999,000 |
| 17 | 2026 | Shërbim Avolxhimi | Marrëveshje Kuader | Shërbime | mirembajtje | 2(dy) vjecare | 50,000,000 | 50,000,000 |
| 18 | 2026 | Karburant 2 lote benzin naftë | Marrëveshje Kuader | Mallra | mallra | 1(një) vjecare | 50,000,000 | 50,000,000 |
| 19 | 2026 | Shërbim ROJE | Kontratë | Shërbime | admin | 1(një) vjecare | 7,600,000 | 7,600,000 |
| 20 | 2026 | Dizifektim 3ddd | Kontratë | Shërbime | admin | 1(një) vjecare | 4,000,000 | 4,000,000 |
| 21 | 2026 | Mirëmbajtje ,Rrjetezim , sistem kamera | Kontratë | Shërbime | admin | 1(një) vjecare | 25,000,000 | 25,000,000 |
| 22 | 2026 | Implementim ISO 27001 | Kontratë | Shërbime | admin | 1(një) vjecare | 4,000,000 | 4,000,000 |
| 23 | 2026 | Shërbim emaili | Kontratë | Shërbime | admin | 1(një) vjecare | 3,000,000 | 0 |
| 24 | 2026 | Printer termik per faturim korent | Kontratë | Mallra | admin | 1(një) vjecare | 3,000,000 | 3,000,000 |
| 25 | 2026 | Bileta Udhëtimi | Sistem Dinamik | Sistem Dinamik | admin | 1(një) vjecare | 3,000,000 | 3,000,000 |
| 26 | 2026 | Shpenzime te ndyshme | Blerje te vogla | Blerje te vogla | # | 1(një) vjecare | 30,000,000 | 30,000,000 |





Totale

pa tvsh

756,598,000

739,599,000

Nje nder investime me te nevojshme "Ndërtim puse dublikant, rikonstruksion, rrethim dhe pastrim të puseve ekzistuese në Njësitë Durrës dhe Rrogozhinë, Burimi: Çermëne, Shkallaur, Fushë-Kuqe, Greth i Madh, Greth i Mesëm, Gosë, Ballaj, Vlibashtovë, Harizaj dhe Pus-prove ne Llaspot Krujë" me vlore 98,000,000 leke pa tvsh, nuk do te realizohet per arsyen e vetme te rialokimit te fondeve per proceduren "Furnizim dhe vendosje elektropompa në stacionin e pompave Fushë-Milot" me qellim mos rendimin e shoqerise nga ana e likuiditetit.

Si me poshte Lista e Investimeve me Fondet e Shoqerise e ndryshuar :

| Emërtim Njesia | Emërtim objekti | Vlera (lekë) Ishte | Vlera (lekë) Behet | Vlera e supervizionit (lekë me t.v.sh) Ishte | Vlera e supervizionit (lekë me t.v.sh) Behet | Vlera e kolaudimit (lekë me t.v.sh) Ishte | Vlera e kolaudimit (lekë me t.v.sh) Behet |
|--|---|--------------------|--------------------|--|--|---|---|
| INVESTIMET E PARASHIKUARA 2026-FOND SHRUKD | | | | | | | |
| Durres, Kavaje, Rrogozhine | Ndërtim puse dublikant, rikonstruksion, rrethim dhe pastrim të puseve ekzistuese në Njësitë Durrës dhe Rrogozhinë, Burimi: Çermëne, Shkallaur, Fushë-Kuqe, Greth i Madh, Greth i Mesëm, Gosë, Ballaj, Vlibashtovë, Harizaj dhe Pus-prove ne Llaspot Krujë | 98,000,000 | 0 | 1,856,120 | 0 | 278,418.00 | 0.00 |
| Durres | Rehabilitimi i stacioneve të pompimit të rrjetit të kanalizimeve Shkembj Kavajes-Durres-ITUN Vrin, Bashkia Durres | 70,000,000 | 70,000,000 | 1,468,600 | 1,468,600 | 220,290.00 | 220,290.00 |
| Durres | Rehabilitimi i Impiantit të Trajtimit të Ujrave të Ndotura Kavaje, Bashkia Kavaje | 90,000,000 | 90,000,000 | 1,751,400 | 1,751,400 | 262,710.00 | 262,710.00 |
| Durres | Projekti i Rrjeteve Inzhinierike FU dhe KUN nga kufiri prones deri te Pika e Lidhjes, Investimi Marina | | 28,888,000 | | 537,317 | | 80,600 |
| Durres | Furnizim dhe vendosje elektropompa në stacionin e pompave Fushë-Milot | | 150,000,000 | | | | |
| Total investime Fonde SHRUKD (lekë pa t.v.sh) | | 258,000,000 | 338,888,000 | 5,076,120 | 3,757,317 | 761,418 | 563,600 |

Investimet jane nje vlore e shtuar e kapitalit , sidmos per Shoqerine tone qe vijon me kapital negativ , ku cdo investim zvogelon vleren negative te saj.



**UJËSJËTËLLËS
KANALIZIME
RAJONI DURRËS**

Adresa: L.17.Rr.Dalip Peza e-mail: info@akdurres.al

Investimi do të kalojë në kohën e një periudhe 12 mujore , ndaj dhe likuiditeti do të jetë variabël për ti dhënë hapësirë shoqërisë dhe të mos e rëndojë atë.

TABELA PERFUNDIMTARE E LIBRIT TE RI TE PROKURIMEVE VITI 2026 :

| Nr. | Viti | Objekti i prokurimit | Kontratë/ Marrëveshje Kuader | Tipi i kontratës | Kategoria shpenzimeve | Kohëzgjatja e kontratës | BUXHET 2026 Rishikuar |
|-----|------|--|------------------------------------|---------------------|--------------------------|----------------------------|-----------------------------|
| 1 | 2026 | Blerje materiale dhe pajisje elektrike,vegla,pajisje mekanike | Marrëveshje Kuader | Mallra | materiale | 1 (një) vjecare | 100,000,000 |
| 2 | 2026 | Blerje materiale hidraulike | Marrëveshje Kuader | Mallra | materiale | 1 (një) vjecare | 200,000,000 |
| 3 | 2026 | Blerje materiale kompjuterike dhe informatike | Kontratë | Mallra | materiale | 1 (një) vjecare | 25,000,000 |
| 4 | 2026 | Blerje reagentesh, pajisje laboratorit dhe Impjanti | Kontratë | Mallra | materiale | 1 (një) vjecare | 20,000,000 |
| 6 | 2026 | Blerje pjese kombini per automjete,riparim,mirembajtje | Marrëveshje Kuader | Mallra | materiale | 1 (një) vjecare | 40,000,000 |
| 7 | 2026 | Sigurim i automjeteve | Kontratë | Shërbime | riparim | 1 (një) vjecare | 3,000,000 |
| 8 | 2026 | Blerje automjete dhe makineri | Kontratë | Mallra | admin | 1 (një) vjecare | 30,000,000 |
| 9 | 2026 | Blerje materiale inerte | Marrëveshje Kuader | Mallra | materiale | 1 (një) vjecare | 15,000,000 |
| 10 | 2026 | Shërbimi i përmirësimit dhe mirëmbajtjes Softëere-it | Kontratë | Shërbime | admin | 1 (një) vjecare | 15,000,000 |
| 11 | 2026 | Pastrim i kolektoreve te ujerave te ndotura | Kontratë | Shërbime | riparim | 1 (një) vjecare | 60,000,000 |
| 12 | 2026 | Shërbim Kontabiliteti ,Implementim dhe Mirembajtje | Kontratë | Shërbime | admin | 1 (një) vjecare | 5,000,000 |
| 13 | 2026 | Blerje kimikate | Marrëveshje Kuader | Mallra | admin | 1 (një) vjecare | 35,000,000 |
| 14 | 2026 | Implimentimi i shërbimit të fiskalizimit dhe mirembajtje vjetore | Kontratë | Shërbime | admin | 1 (një) vjecare | 5,000,000 |
| 15 | 2026 | GIS Mirembajtje | Kontratë | Shërbime | admin | 1 (një) vjecare | 9,999,000 |
| 16 | 2026 | Shërbim Avokllimi | Marrëveshje Kuader | Shërbime | mirembajtje | 2(dy) vjecare | 50,000,000 |
| 17 | 2026 | Karburant 2 lote benzin naftë | Marrëveshje Kuader | Mallra | mallra | 1 (një) vjecare | 50,000,000 |
| 18 | 2026 | Shërbim ROJE | Kontratë | Shërbime | admin | 1 (një) vjecare | 7,600,000 |



**UJËSJELLËS
KANALIZIME
RAJONI DURRËS**

Adresa: L. 17. Rr. Dalip Peza e-mail: info@ukdurret.al

| | | | | | | | |
|---------------|------|--|-----------------|-----------------|---------|----------------|--------------------|
| 19 | 2026 | Dizifektim 3ddd | Kontratë | Shërbime | admin | 1(një) vjecare | 4,000,000 |
| 20 | 2026 | Mirembajtje ,Rrrijetezim , sistem kamera | Kontratë | Shërbime | admin | 1(një) vjecare | 25,000,000 |
| 21 | 2026 | Implementim ISO 27001 | Kontratë | Shërbime | admin | 1(një) vjecare | 4,000,000 |
| 22 | 2026 | Printer termik per faturim korent | Kontratë | Mallra | admin | 1(një) vjecare | 3,000,000 |
| 23 | 2026 | Bileta Udhëtimi | Sistem Dinamik | Sistem Dinamik | admin | 1(një) vjecare | 3,000,000 |
| 24 | 2026 | Shpenzime te ndyshme | Blerje te vogla | Blerje te vogla | # | 1(një) vjecare | 30,000,000 |
| Totale | | | | | pa tvsh | | 739,599,000 |

Per INVESTIMET 2026 :

| Nr. | Emertim Njesia | Emërtim objekti | Vlera (lekë) | Vlera e supervizionit (lekë me t.v.sh) | Vlera e kolaudimit (lekë me t.v.sh) |
|--|---|---|--------------------|--|-------------------------------------|
| I | INVESTIMET E PARASHIKUARA 2026-FOND SHRUKD | | | | |
| | Durres | Rehabilitimi i stacioneve të pompimit të rrjetit të kanalizimeve Shkembli Kavajes-Durres-ITUN Vrrin, Bashkia Durres | 70,000,000 | 1,468,600 | 220,290.00 |
| | Durres | Rehabilitimi i Impiantit të Trajtimit të Ujrave të Ndotura Kavajë, Bashkia Kavajë | 90,000,000 | 1,751,400 | 262,710.00 |
| 1 | Durres | Projekti i Rrjeteve Inxhinierike FU dhe KUN nga kufiri prones deri te Pika e Lidhjes, Investimi Marina | 28,888,000 | 537,317 | 80,600 |
| 2 | Durres | Furnizim dhe vendosje elektropompa në stacionin e pompave Pushë-Milot | 150,000,000 | | |
| Total investime Fonde SHRUKD (lekë pa t.v.sh) | | | 338,888,000 | 3,757,317 | 563,600 |

| Nr. | ZONA | INVESTIME ME BUXHET SHTET 2026 | Vlera ne leke | Vlera e kolaudimit ne leke | Vlera e Supervizionit ne leke | Vlera e Oponences ne leke |
|-----|--------|---|---------------|----------------------------|-------------------------------|---------------------------|
| 1 | Durres | Rindertimi i shuarsit te presioni ne Kurate me kapacitet 800 m3, duke perfshiro tubacionin e gizes DN 700 per lidhjen me linjen ekzistuese, rrugen e sherbimit dhe sistemin e monitorimit me kamera | 348,965,081 | 2,442,755 | 366,413 | 376,882 |
| 2 | Shijak | Rivendosje e 3 pompave shtytese (VSD) ne STP si dhe rehabilitimi i nderteses se pusit ne STP Pushe-Kruje | 52,134,330 | 969,698 | 145,454 | 56,305 |



**UJËSJIELLËS
KANALIZIME
RAJONI DURRËS**

Adresa: L.17.Rr.Dalip Peza e-mail: info@ukdurres.al

| | | | | | | |
|--|--------------|---|----------------------|-------------------|------------------|------------------|
| | Kavaje | Permirimi i efencanes se energjize dhe implementimi i paneleve fofovoltaike per shqerime Durrës-Çermë | 9,900,589 | 184,150 | 27,622 | 10,692 |
| 4 | Kavaje | Rikonstruksion i rrjetit të ujësjetësit të fshatrave të Njësisë Administrative Synej dhe Golem, Bashkia Kavaje | 1,490,122,886 | 10,430,860 | 1,564,629 | 1,609,333 |
| 5 | | Rikonstruksion i rrjetit të ujësjetësit në fshatin Butaq, Njësia Adm.Synej Bashkia Kavaje | 75,422,003 | 1,402,849 | 210,427 | 385,604 |
| 6 | Kruje/Durres | Rikonstruksion i rrjetit të ujësjetësit të fshatrave të Njësisë Administrative Fushë-Kuqe dhe Thumanë, Bashkia Kurbin dhe Bashkia Kruje | 1,498,549,911 | 10,489,849 | 1,573,477 | 1,618,434 |
| 7 | Durrës | Rikonstruksion i rrjetit të ujësjetësit të fshatrave të Njësisë Administrative Manëz, Bashkia Durrës | 793,469,279 | 5,554,285 | 833,143 | 856,947 |
| 8 | | Rikonstruksion i Rrjetit Te Ujësjetësit Te Fshatit Te Njësisë Administrative Rushbull, Bashkia Durrës | 385,996,733 | 2,701,977 | 405,297 | 416,877 |
| 9 | Shijak | Rikonstruksion i Rrjetit Te Ujësjetësit Te Fshatrave Te Njësisë Administrative Maminas, Bashkia Shijak | 523,794,497 | 3,666,561 | 549,984 | 565,698 |
| Total Investime Fonde Buxhet Shteti (lekë me t.v.sh) | | | 5,178,355,309 | 37,842,985 | 5,676,446 | 5,896,772 |

- Sa me sipër , propozojme miratimin e Rishikimit te Planit Operacional dhe Financiar te vitit 2026

DEPARTAMENTI TEKNIK

Z.Tonin Doda



DEPARTAMENTI TREGTAR

Zj.Jordita Hoxha



DEPARTAMENTI SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Z.Albano Doda




Konc: Daniela Nano

Migen Dukra

Anjeza Lamo




**UJËSJETËS
KANALIZIME
RAJONI DURRËS**

Adresa: L.17.Rr.Dalip Peza e-mail: info@ukidurres.al



**UJËSJELLËS
KANALIZIME**
RAJONI DURRËS

Adresa: L. 17. Re. Dalip Peza e-mail: info@ukdurrës.al